



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER EDLIRA O. MALAJ  
(GALANXHI)  
ADRESA RR.SAMI FRASHERI,  
PALLATI BLU PERBALLE  
GJIMNAZIT PETRO NINI  
LUARASI, KATI 2  
TEL: 694439947

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 3293

Nr. koleksioni: 1098

Tirane më 19/08/2021

**Ligjet referuese:**

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterisë"

\*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2021053010122169840



**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI  
( TË SHOQËRISË "IKN" SH.P.K)**

Sot, më datë 19.08.2011, para meje Notere EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, RR.SAMI FRASHERI, PALLATI BLU PERBALLE GJIMNAZIT PETRO NINI LUARASI ,KATI 2, u paraqit personalisht:

**PALA SHITËSE:**

**Saimir Mysliu**, atësia Ilmi, amësia Ilirjana, shtetas Shqiptar, lindur në Librazhd dhe banues në TIRANË, me adresë Eduard Mano 03910036; Nd. 20; H. 6; Ap. 17; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 04/12/1978, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033376305 dhe nr. personal H81204009A, në cilësinë e përfaqësuesit të 30% te kuotave te kapitalit te **Shoqërisë INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN"**, me numër unik identifikimi të subjektit NIUS K71828007J.

**PALA BLERËSE:**

**Holta Çota**, atësia Ilmi, amësia Ilirjana, shtetase Shqiptare, lindur në Librazhd dhe banuese në Tiranë, me adresë Sami Frasheri; Nd. Pall 56; H. Shk 6; Ap. Apt 15; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 22/09/1975, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034114409 dhe nr. personal H55922033U.

*Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:*

**KUSHTET PARAPRAKE**

**Shoqëria "IKN" Sh.p.k shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik në me numër unik identifikimi të subjektit NIUS K71828007J, më datë 12/08/1994, me zyrë qendrore në Farke, Tirane.**

Shitesi eshte zoterues i 1 ( nje) kuote qe perben 30% te kapitalit te shoqerise, ku kapitali i shoqerise eshte ne vleren me kapital të regjistruar 1.000.000 lekë.

Sipas kushteve dhe afateve te percaktuara ne kete Kontrate, Shitesi i shtet Bleresit dhe Bleresi i blen Shitesit, Kuoten ne Shitje, ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate.

**NENI I**

**PËRSHKRIMI I OBJEKTIT**

Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse Z. Saimir Mysliu ortak me 30% te kuotave te Shoqërisë "IKN" Sh.p.k, i shtet palës blerëse **Holta Çota**, kuotën prej 10% nga 30% qe ai zotëron në kapitalin e regjistruar të shoqërisë "IKN" Sh.p.k.

Bleresi pranon te bleje nga shitesi kuoten ne shitje qe perben 30% (tridhete perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise e cila konsiston ne 1 (nje) kuote.

Me blerjen nga Bleresi te kuotes ne shitje prej Shitesit, Bleresi behet zoterues i kuotes ne shoqerine e cila perben 10% (dhjete per qind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Bleresi fiton pronesine mbi Kuotat, dhe te gjitha te drejtat e lidhura me pronesine, mbi Kuotat ne Shitje, ne Daten e Nenshkrimit. Bleresit i lind e drejta ne Daten e Nenshkrimit te regjistroje



A2021053010122169840

pronësine e tij mbi Kuotën në Shitje, në librat e Shoqërisë dhe në çdo organ tjetër kompetent në Shqipëri.

**NENI 2**

**ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS**

2.1 Çmimi i shitjes së kuotës së kapitalit të shoqërisë që Blerësi i detyrohet Shitësit për blerjen e saj është në vlerë monetare prej 500 000 leke (peseqinde mijë leke).

2.2 Palët deklaronjë se nga ana e Blerësit do të likuidohet vlera monetare e sipërcituar prej 500 000 leke (peseqinde mijë leke), me transfertë bankare nga Blerësi në llogarinë e Shitësit, nëpërmjet një Banke të nivelit të dytë, e cila përbën vlerën e plotë të pjesës së kuotës së shitësit, për të cilën palët kanë rënë dakord.

**NENI 3**

**BAZA LIGJORE**

3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;

3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

**NENI 4**

**TRANSFERIMI I KUOTAVE**

E drejta e pronësise së Shitësit mbi kuotën e Blerësit do të transferohet në favor të Blerësit në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e transferimit të kuotës në favor të Blerësit dhe për regjistrimin e këtij transferimi në Shqipëri.

Me transferimin e kuotës në pronësi të blerësit, Znj. Holta Çota do të bëhet ortak i shoqërisë dhe do të zotërojë kuotën që përben 70% të kuotave të saj ekzistuese dhe 10% të kuotave që z. Saimir Mysliu po i shet të kapitalit të shoqërisë.

Z.Saimir Mysliu deklaron se jep pelqimin dhe është dakort me shitjen e kuotave, të kesaj shoqërie.

Administrator i shoqërisë do të mbetet Z. Ilmi Mysliu.

Z.Saimir Mysliu do të zotërojë vetëm 20% të kuotave të shoqërisë pas nënshkrimit të kesaj kontrate.

Znj. Holta Çota do të zotërojë 80% të kuotave të shoqërisë.

Znj. Enda Vogli, me nr. personal J85630035D do të kryjë të gjitha procedurat pranë QKB për transferimin e kuotave.

Ky transferim është autorizuar nga Vendimi i ortakut të vetëm të shoqërisë i datës 19/08/2021

**NENI 5**

**PERFAQESIMET DHE GARANCITE**

Shitësi deklaron dhe garanton blerësin për sa më poshtë vijon :

Shitësi është pronar i 30% të kuotave, objekt i kesaj kontrate, sikurse vërtetohet nga ekstrakti bashkëlidhur kontratës, dhe se nuk ka ndonjë pretendim nga ndonjë palë e tretë ndaj të drejtës së pronësise mbi Kuotën, ekzistues apo të mundshëm.

Shitësi nuk është në kushtet e mospërmbushjes së ndonjë marrëveshjeje në të cilën është palë, e cila mund të ketë efekt negativ mbi të drejtën e pronësise mbi Kuotën objekt i kesaj kontrate.

Kuota nuk është objekt i ndonjë kufizimi, barre apo pengu në favor të ndonjë palë të tretë, por edhe nëse do të ketë çdo detyrim ndaj të tretëve do të merret persiper nga pala blerëse, duke mos pasur pretendime as sot as në të ardhmen.



A2021053010122169640

Shitesi deklaron dhe garanton Bleresin se ka te drejte te shesi apo te prokuroje transferimin e Kuotave tek Bleresi sipas termave te pershkruara ne kete kontrate.

**NENI 6**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Cdo njoftim, aplikim, ose komunikim tjeter qe duhet dhene ose bere sipas kesaj kontrate drej Bleresit ose Shitesit do te behet me shkrim pervec kur parashikohet ndryshe ne kontrate. Njoftimi, kerkesa ose komunikim tjeter do te konsiderohet qe i eshte dhene ose bere kur ai do ti dorezohet dorazi, me poste pales te ciles i kerkohet ose lejohet ti jepet ose here ne adresen e pales ose adrese tjeter qe pala ka caktuar, duke e njoftuar palen tjeter per te dhene apo bere njoftime te tilla, aplikime ose komunikime te tjera.

**NENI 7**

**LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI.**

Kjo kontrate do te hartohet dhe interpretohet ne perputhje me ligjin Shqiptar. Cdo mosmarreveshje, polemike ose pretendim qe ka ardhur si rezultat i zbatimit te kesaj kontrate ose prishje, mbarim, ose pavlefshmeri prej kesaj, do te zgjidhet nga gjykata kompetente.

**NENI 8**

**ANEKSET E KONTRATËS**

8.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneks të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve
- Ekstrakt i Regjistrit Tregtar për Shoqërinë "IKN" Sh.p.k.
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

**NENI 9**

**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

9.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

9.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

9.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALËT KONTRAKTUESE**

**PALA SHITËSE**

Shoqëria INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN",  
Perf. nga Z.SAIMIR MYSLIU

**PALA BLERËSE  
HOLTA ÇOTA**

*Holta Çota*



**NOTER**

**EDLIRA O. MALAJ (GALANXHI)**



**REZULTATET E KËRKIMIT**

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-20210819125650427  
Data e Rezultatit të Kërkimit: 19.08.2021  
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 12:56:50PM  
Lloji i Kërkimit:  
Numri i Dokumentit: D-400-574-972  
Referenca e Përdoruesit:

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0**

INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM IKN SH.P.K.



*nda ceshkole*  
19.08.2021  
REGJISTRI I BARRËVE SIGURUESE